Vendim nr. 243, datë 15.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Genti Ibrahimi, Anëtar
Ilir Toska, Anëtar

në datën 15.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (H) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **HAVA KRASNIQI,** përfaqësuar nga avokat Endri Kotherja, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit 00-2025-4265, datë 09.12.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Hava Krasniqi (Dula) bashkë me N.S.(D.) janë trashëgimtare të O.D., ndërsa ky i fundit është trashëgimtar i subjektit të shpronësuar A.D. Me vendimin nr. 50, datë 01.11.1994 (*vendimi nr. 50/1994*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Kavajë *(KKKP-ja, Kavajë*), bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", të ndryshuar, trashëgimtarëve të A.D. u është njohur pronësia mbi pasurinë "truall", me sipërfaqe 1685 m², në fshatin Qerret, komuna Golem, rrethi Kavajë dhe për shkak se kjo pasuri ka qenë e zënë në kuptim të ligjit, atyre u është njohur e drejta e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike.

2. Duke qenë se e drejta e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike nuk është realizuar, një nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, N.S.(D.), i është drejtuar gjykatës me padi kundër Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), me objekt nxjerrjen e aktit përkatës administrativ sipas dispozitivit të vendimit nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1178, datë 18.09.2014, ka vendosur detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit për sipërfaqen 1685 m², me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike në fshatin Qerret, komuna Golem, rrethi Kavajë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 03.11.2014 dhe ai është vënë në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor. Veprimet përmbarimore janë kundërshtuar gjyqësisht nga AKKP-ja dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1056, datë 05.10.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 4753, datë 14.11.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Në datën 27.05.2016 Agjencia e Trajtimit të Pronave (*ATP*), në zbatim të ligjit nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" (*ligji nr. 133/2015*), i është drejtuar Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të regjistrit të vendimeve që kanë njohur të drejtën për kompensim dhe të vlerësimit të vendimeve të viteve 1993 dhe 1994. Publikimi është realizuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 16, datë 30.05.2016, ku emri i subjektit të shpronësuar A.D. është evidentuar me numër rendor 2845 dhe rezulton fillimisht vlerësimi "*zero*", për shkak të mungesës së dokumentacionit. Pas plotësimit të dokumentacionit është bërë përditësimi i vlerësimit, i botuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 8, datë 04.03.2019, ku emri i subjektit të shpronësuar A.D. është me numrin

rendor 2 dhe vlerësimi është përcaktuar në shumën 168.500 lekë. Në këtë vlerësim, megjithëse zona kadastrale ku ndodhej prona ishte përcaktuar ZK 3101, Qerret, Kavajë, për çmimin ATP-ja i ishte referuar gabimisht ZK 3102. Pas korrigjimit të këtij gabimi, ATP-ja ka kryer rivlerësimin në shumën 197.145 lekë, i cili është botuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 46, datë 19.12.2019, me numër rendor 3.

4. Kërkuesja, duke mos qenë dakord me vlerësimin fillestar prej 168.500 lekësh, ka kërkuar vlerësim të ri. Me shkresën e datës 01.04.2019, ATP-ja, ndër të tjera, ka sqaruar se: "*[…] Nga verifikimi në regjistrin e vendimeve të vitit 1993-1994, të cilat iu kanë njohur subjekteve të shpronësuara të drejtën e kompensimit, rezulton se vendimi nr. 50/1994 i KKKP-së, Kavajë, në emër të subjektit të shpronësuar A.D., është publikuar i vlerësuar financiarisht. Për sa i takon mënyrës së vlerësimit financiar të vendimit, ju sqarojmë: me vendimin nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë, subjektit të shpronësuar A.D. i është njohur e drejta e kompensimit për sipërfaqen 1685 m². Në pikën 1/a të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" (VKM nr. 223/2016) është përcaktuar metodologjia e vlerësimit. Referuar dokumentacionit ligjor dhe hartografik të administruar në dosje nuk është bërë i mundur përcaktimi i zërit kadastral të origjinës për pronën e njohur me vendimin nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë. [...] Në bazë të përcaktimeve ligjore, në rastet kur ATP-ja, referuar dokumentacionit që disponon, është në pamundësi objektive për të vlerësuar vendimin përfundimtar, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone. Gjithashtu, referuar dokumentacionit hartografik, zona kadastrale në të cilën ndodhet aktualisht prona është ZK 3102, Qerret, Kavajë. Vlera e tokës pyll për ZK 3102 është 100 lekë/m². Vlerësimi financiar për sipërfaqen e pronës për të cilën është njohur e drejta e kompensimit me vendimin nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë, përllogaritet në vlerën 1685 m² x 100 1ekë/m² = 168.500 lekë. […]".*

5. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kundërshtuar vlerësimin financiar të ATP-së si antikushtetues dhe në kundërshtim me KEDNJ-në dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), si dhe duke kërkuar aplikimin e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike, me vlerën e pasurisë së paluajtshme "truall" sipas VKM-së nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna" (*VKM-ja nr. 1620/2008*), duke pretenduar, ndër të tjera, se çështja ndodhej

në proces shqyrtimi përpara GJEDNJ-së, se vendimi nr. 50/1994 i KKKP-së, Kavajë ishte titull ekzekutiv, se zëri kadastral i origjinës së pronës ishte "truall" dhe se për vlerësimin duhej të zbatohej VKM-ja nr. 1620/2008 dhe jo VKM-ja nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" (*VKM-ja nr. 89/2016*).

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 53 (86-2020-836), datë 02.07.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Për sa i përket, fillimisht, pretendimit se çështja ndodhej në shqyrtim edhe përpara GJEDNJ-së, ajo gjykatë ka vlerësuar se, sipas nenit 3 të ligjit nr. 133/2015, ky ligj i shtrin efektet, për sa i takon vlerësimit financiar, edhe ndaj çështjeve në shqyrtim përpara gjykatave të të gjitha niveleve, Gjykatës së Lartë dhe GJEDNJ-së, ndaj nuk kishte pengesë procedurale për trajtimin e vlerësimit financiar nga ATP-ja dhe gjykata. Gjykata e apelit ka evidentuar, gjithashtu, se neni 19 i ligjit nr. 133/2015 parashikon të drejtën e ankimit kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja vetëm për sa i përket vlerës së kompensimit dhe se, sipas nenit 6 të këtij ligji, prona e njohur për kompensim vlerësohet mbi bazën e zërit kadastral që ajo ka pasur në kohën e shpronësimit.

7. Në lidhje me zërin kadastral dhe vlerën e kompensimit, gjykata e apelit ka konstatuar se, pas korrigjimit të gabimit në vlerësimin fillestar, zona kadastrale ku ndodhet aktualisht prona është ZK 3101, Qerret, Kavajë dhe se, sipas hartës në fuqi të miratuar me VKM-në nr. 89/2016, vlera për tokën "kullotë-livadh" në këtë zonë është 117 lekë/m². Për rrjedhojë, vlerësimi financiar për sipërfaqen prej 1685 m² është 197.145 lekë. Sipas gjykatës së apelit, për trajtimin e kërkesës ATP-ja është bazuar në pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 133/2015 dhe në pikën 3, shkronja "d", të VKM-së nr. 223/2016, sipas të cilave zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të tij, të hartës së kohës së shpronësimit ose të hartës më të afërt me këtë kohë, ndërsa, në pamundësi objektive për përcaktimin e tij, vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal të përcaktuar në hartën e vlerës për njësinë administrative dhe kategorinë përkatëse të pronës. Në këtë kuadër, ajo gjykatë ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkueses se zëri kadastral i origjinës së pronës ishte "truall", duke arsyetuar se dokumentacioni ligjor i administruar në dosje nuk ishte i mjaftueshëm për përcaktimin e zërit kadastral, ndërsa skica bashkëlidhur vendimit të KKKP-së, Kavajë nuk mundësonte planvendosjen e pronës dhe nuk kishte ndonjë hartë tjetër ku ATP-ja të mund të bazohej. Po kështu, vendimi gjyqësor me objekt vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, i ndodhur në dosjen e ATP-së, nuk mundësonte përcaktimin e zërit kadastral dhe nuk kishte hartë të pronës. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesja nuk kishte arritur të provonte

pretendimin për zërin kadastral "truall". Për sa i përket pretendimit për aplikimin e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike sipas vlerës së pasurisë së paluajtshme "truall", të përcaktuar me VKM-në nr. 1620/2008, gjykata e apelit ka vlerësuar se ky pretendim ishte i pabazuar, pasi VKM-ja në fjalë ishte shfuqizuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

8. Përpara shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 20.04.2021, në çështjen *Ruçi dhe Bejleri e të tjerë kundër Shqipërisë* (191 kërkesa), ka shqyrtuar një listë çështjesh kundër Shqipërisë, ku bëjnë pjesë edhe dy çështje të kërkueses Hava Krasniqi dhe konkretisht, në numrin rendor 175 të listës, është edhe aplikimi nr. 52909/16, i dorëzuar në atë gjykatë në datën 01.09.2016, për cenimin e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj dhe që i referohet vendimit nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë. Për sa u përket detajeve të zbatimit, sipas tabelës rezulton se "*ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit dhe ankimi i kërkuesve ndaj vendimit të ATP-së është pezull në Gjykatën Administrative të Apelit*.". Në lidhje me këto kërkesa GJEDNJ-ja, fillimisht, ka vendosur t'i shqyrtojë ato në një vendim të vetëm dhe në përfundim i ka deklaruar të papranueshme. Sipas GJEDNJ-së, si pjesë e zbatimit të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerë*, autoritetet kanë paraqitur një zgjidhje të brendshme, duke miratuar ligjin nr. 133/2015, i cili ka parashikuar një mjet të ri të brendshëm për realizimin e së drejtës së kompensimit. Ky mjet është shqyrtuar në çështjen *Beshiri dhe të tjerë,* ku është vlerësuar se, sipas informacionit të disponueshëm në atë kohë dhe në kushtet e përcaktuara në atë vendim, ai ishte efektiv në kuptim të neneve 35, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës. Pas dhënies së vendimit për çështjen *Beshiri dhe të tjerë,* i datës 15.02.2021, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) dha vendimin për kontrollin *in abstracto* të disa dispozitave të ligjit për pronat nr. 133/2015, duke shfuqizuar nenin 7, paragrafi 2, shkronjat "a" dhe "b", duke rikonfirmuar aspektet kryesore të skemës së kompensimit. Sipas GJEDNJ-së, në këtë vendim, i cili sanksiononte përcaktimin e vlerësimit financiar kur një ish-pronar ka përftuar rikthim të pjesshëm të mëparshëm të pronës së shpronësuar, ka vepruar me konsistencë dhe është përpjekur të zbatonte udhëzimin e GJEDNJ-së se shuma e kompensimit nuk duhej të ishte më pak se 10% e vlerës për të cilën ish-pronarët do të kishin të drejtë, nëse vlerësimi financiar kryhej duke iu referuar kategorisë aktuale kadastrale të pronës së shpronësuar.

9. Po në vendimin e saj të datës 20.04.2021, në lidhje me ankesat e ngritura sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj, për kërkesat e përshkruara në tabelën 2 bashkëlidhur vendimit (rreshtat nr. 157-192 të shtojcës), ku bën pjesë edhe kërkesa e

kërkueses (nr. 175), GJEDNJ-ja ka vlerësuar se procedimet e brendshme në lidhje me përcaktimin e shumës së kompensimit janë pezull përpara gjykatave kombëtare, ndaj trajtimi i këtyre ankimeve do të ishte i parakohshëm, ndaj ato duhej të deklaroheshin të papranueshme sipas nenit 35, paragrafët 1 dhe 4, të Konventës. Pavarësisht këtij konkluzioni, GJEDNJ-ja sjell në vëmendje parashikimet e bëra në paragrafin 222 të vendimit të saj për çështjen *Beshiri dhe të tjerë* në lidhje me kushtet të cilat duhet të përmbushin autoritetet në mënyrë që zgjidhja të vijojë të mbesë efikase, veçanërisht dhënia e kompensimit për jo më pak se 10% të vlerës për të cilën kanë të drejtë ish-pronarët nëse vlerësimi financiar është bërë në referencë të kategorisë aktuale kadastrale të pronës së shpronësuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Ruçi dhe Bejleri e të tjerë kundër Shqipërisë, paragrafët 21-32*).

10. Pas dhënies së vendimit nga GJEDNJ-ja, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4265, datë 09.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Gjykata e Lartë ka evidentuar se, brenda juridiksionit të saj rishikues si gjykatë ligji, i takon rekursuesit të parashtrojë dhe argumentojë shkaqet që përmbushin kërkesat e kësaj dispozite. Në respekt të standardeve të KEDNJ-së dhe atyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si dhe në mbështetje të nenit 473/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ajo ka çmuar se nga shqyrtimi i rrethanave të konstatuara nga gjykata e faktit dhe shkaqeve të rekursit nuk rezultonte i argumentuar asnjë shkak i vlefshëm ligjor në kuptim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe as ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet *ex officio* nga Gjykata e Lartë.

11. Në datën 12.05.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkueses

12. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka pasur në konsideratë se rekursi përmbante argumente ligjore që përbënin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të lidhura me zbatimin e ligjit nr. 133/2015 dhe,

në veçanti, me detyrimin e ATP-së për të provuar zërin kadastral të sipërfaqes objekt vlerësimi financiar. Në çështje të ngjashme Kolegji Administrativ ka pranuar se, në çështjet që lidhen me vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim, organi publik (ATP-ja) ka barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e vendimit të tij dhe përcaktimin e saktë të zërit kadastral të pronës mbi bazën e dokumenteve zyrtare dhe akteve të administruara. Referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur për ligjin e zbatueshëm dhe për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Vendimi i kundërshtuar nuk përmban analizë konkrete juridike të këtyre shkaqeve dhe nuk jep përgjigje të arsyetuar për to.

12.1.2. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka pasur në konsideratë pretendimet për parregullsitë e vlerësimit financiar të ATP-së dhe mungesës së një hetimi të plotë nga Gjykata Administrative e Apelit për përcaktimin e zërit kadastral të pronës. Dokumenti i vlerësimit ekonomik i datës 22.05.2019 nuk ishte i firmosur nga personat përgjegjës dhe nuk shoqërohej me shkresë përcjellëse që ta formalizonte si akt të ATP-së, ndërsa në formular ishte shënuar se nga vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë nuk përcaktohej zëri kadastral i origjinës. Po kështu, ATP-ja nuk kishte administruar dokumentacionin e organeve kompetente të kohës për ndryshimin e pretenduar të zërit kadastral të pronës. Nga ana tjetër, sipas shkresës së datës 06.02.2020, të Këshillit të Qarkut Tiranë, në arkivin e DAMT-së ndodhen dy plane rregulluese për fshatin Qerret, të miratuara nga Komiteti Ekzekutiv respektivisht me vendimet nr. 82, datë 26.05.1986 dhe nr. 49, datë 24.02.1989, çka tregon se zona ku ndodhet prona ka qenë objekt studimi ndër vite. Duke pasur në konsideratë se ky institucion ka nisur funksionimin në vitin 2000 pas shkrirjes së këshillave të rretheve, nuk përjashtohet mundësia e studimeve më të hershme të fshatit Qerret, për rrjedhojë e administrimit të dokumentacionit të mëtejshëm për përcaktimin e zërit kadastral në kushtet kur nuk provohej data e marrjes së padrejtë të pronës.

12.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, referuar ligjit procedural civil dhe administrativ, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë

duhej të kishte proceduar me pranimin për shqyrtim të rekursit, për sa kohë ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Në këtë mënyrë është cenuar edhe *e drejta e ankimit,* për sa kohë çështja ishte shqyrtuar fillimisht nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë, në ushtrim të juridiksionit të saj rishikues, duhej të shqyrtonte shkaqet e rekursit dhe të jepte një vendim të arsyetuar për to.

12.1.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë,* pasi mospranimi i rekursit i ka pamundësuar kërkueses shqyrtimin e pretendimit se gjykata e apelit nuk kishte kryer një hetim të plotë lidhur me zërin kadastral të pronës dhe se çështja duhet të kthehej për rigjykim, me qëllim që të administrohej dokumentacioni përkatës dhe ATP-ja të përmbushte barrën e provës për përcaktimin e zërit kadastral të sipërfaqes objekt vlerësimi financiar.

12.2. *Parimi i sigurisë juridike,* së pari, *në drejtim të gjësë së gjykuar,* pasi nuk janë respektuar vendimet përfundimtare që kanë njohur dhe urdhëruar realizimin e së drejtës së kompensimit, konkretisht vendimi nr. 50/1994 i KKKP-së, Kavajë, me të cilin është njohur e drejta e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike në fshatin Qerret, si dhe vendimi nr. 1178, datë 18.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me të cilin AKKP-ja është detyruar të nxjerrë aktin administrativ për realizimin e kësaj të drejte. Së dyti, në drejtim të qëndrueshmërisë dhe uniformitetit të praktikës gjyqësore, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme në drejtim të barrës së provës në përcaktimin e zërit kadastral, ndërkohë që zgjidhjet kontradiktore në çështje të njëjta duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës nëpërmjet mekanizmave të parashikuara për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka qenë as e *paanshme* në trajtimin e çështjes së kërkueses, pasi rekursi përmbante shkaqet ligjore sipas nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

12.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit,* i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi rekursi përmbante shkaqe për mosrespektimin e ligjit material, konkretisht të nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 133/2015, ndërsa vendimi i kundërshtuar ka favorizuar ATP-në në kundërshtim me interesat e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, të cilëve u mohohet kompensimi sipas vendimit të formës së prerë nr. 50/1994 të KKKP-së,

Kavajë. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar janë vënë në kushte pabarazie edhe në raport me trashëgimtarë të subjekteve të tjera të shpronësuar në situata të ngjashme, për të cilët Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pranuar se barra e provës për ligjshmërinë e vlerësimit dhe për përcaktimin e saktë të zërit kadastral i takon ATP-së. Gjykata e Lartë ka zbatuar një standard të ndryshëm nga ai i ndjekur në raste të ngjashme.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji do të ndalet në verifikimin e kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, duke vlerësuar nëse pretendimet e parashtruara ngrenë çështje të natyrës kushtetuese dhe nëse ato janë të argumentuara në nivelin e kërkuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

15. Sipas kërkueses, është cenuar *e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, referuar ligjit procedural civil dhe administrativ, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të kishte proceduar me pranimin e rekursit për shqyrtim, për sa kohë ai përmbante shkaqe

nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Mbi të njëjtat argumente, ajo ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së ankimit*, si dhe të *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si dhe të *së drejtës së mbrojtjes*, pasi mospranimi i rekursit i ka pamundësuar shqyrtimin e pretendimeve për mungesën e një hetimi të plotë nga Gjykata Administrative e Apelit dhe për barrën e ATP-së për të provuar zërin kadastral të pronës.

16. Kolegji vëren se, pavarësisht mënyrës së emërtimit të këtyre pretendimeve, argumentet e kërkueses nuk vënë në diskutim krijimin, përbërjen ose kompetencën ligjore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, por mënyrën sesi ai ka vlerësuar plotësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe vendimmarrjen për mospranimin e tij. Për rrjedhojë, ato nuk ngrenë ndonjë çështje në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore me praninë e palëve u përket kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, pikat 1 dhe 2 të nenit 61 parashikojnë se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, kurse neni 62 ka përcaktuar rastet kur gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe procedurën që ndiqet në një rast të tillë. Po kështu, Gjykata ka vlerësuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t`u dëgjuar personalisht edhe përpara Gjykatës së Lartë, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve. Për më tepër, në rastin konkret, kërkuesja nuk ka pretenduar se është penguar të paraqesë rekursin dhe argumentet në mbështetje të tij, të njihet me parashtrimet e palës tjetër ose t'i kundërshtojë ato apo se është vendosur në një pozitë procedurale më pak të favorshme. Pretendimi i saj lidhet, në thelb, me mënyrën sesi Gjykata e Lartë ka vlerësuar plotësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe me vendimmarrjen për mospranimin e tij. Për rrjedhojë, vetëm kjo rrethanë nuk evidenton cenim të *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* ose të *së drejtës së mbrojtjes*, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

17. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar*, Kolegji vëren se kërkuesja i referohet vendimit nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë, me

të cilin trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar u është njohur e drejta e kompensimit me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike, si dhe vendimit nr. 1178, datë 18.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka marrë formë të prerë, me të cilin AKKP-ja është detyruar të nxjerrë aktin administrativ për realizimin e kësaj të drejte. Kolegji vëren se procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues nuk ka pasur për objekt ekzistencën e së drejtës së kompensimit të njohur me këto vendime dhe as vlefshmërinë e tyre, por ligjshmërinë e vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja në zbatim të kuadrit ligjor të miratuar më pas me ligjin nr. 133/2015. Në këtë proces nuk është rishqyrtuar titulli juridik i njohur në favor të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar dhe as është mohuar ekzistenca e së drejtës së kompensimit. Mosmarrëveshja e parashtruar nga kërkuesja ka pasur për objekt mënyrën e vlerësimit financiar dhe të realizimit të kësaj të drejte sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm për procesin e kompensimit. Në këto rrethana, kërkuesja nuk ka arritur të evidentojë se gjykatat kanë rihapur ose rivendosur në diskutim një çështje juridike të zgjidhur përfundimisht me vendimet e mësipërme, në kuptimin kushtetues të parimit *të gjësë së gjykuar*. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

18. Për sa i përket argumentit të dytë në lidhje me pretendimin për *sigurinë juridike* të lidhur edhe me *parimin e barazisë përpara ligjit*, sipas kërkueses, Gjykata e Lartë ka mbajtur në çështjen e saj një qëndrim të ndryshëm nga ai në çështje të tjera për vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim, në të cilat ka vlerësuar se barra e provës për ligjshmërinë e veprimit administrativ dhe për përcaktimin e zërit kadastral i takon ATP-së. Gjykata ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 77, datë 02.12.2025; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuese/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenojnë parimin e sigurisë juridike për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimet nr. 77, datë 02.12.2025; nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimet e Gjykatës së Lartë të referuara nga kërkuesja nuk janë vendime njësuese ose unifikuese të praktikës gjyqësore dhe, për më tepër,

lidhen me çështje në të cilat përcaktimi i zërit kadastral dhe vlerësimi i përmbushjes së barrës së provës kanë qenë të lidhura me dokumentacionin konkret të administruar në secilën dosje. Për rrjedhojë, vetëm fakti se në çështje të tjera Gjykata e Lartë ka arritur në përfundime të ndryshme në drejtim të hetimit gjyqësor ose të përmbushjes së barrës së provës nga ATP-ja nuk është i mjaftueshëm për të treguar se çështja e kërkueses paraqiste rrethana faktike dhe juridike të krahasueshme ose se ndaj saj është zbatuar një standard juridik i ndryshëm. Në këto kushte, kërkuesja nuk ka arritur të evidentojë as cenim të sigurisë juridike dhe as trajtim të ndryshëm të situatave juridikisht të krahasueshme në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

20. Për sa i përket pretendimit të kërkueses për mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ajo nuk ka paraqitur ndonjë argument konkret që lidhet me paanshmërinë subjektive ose objektive të trupit gjykues, por e ka mbështetur këtë pretendim në mënyrën e vlerësimit të rekursit dhe në rezultatin e procesit, pa evidentuar ndonjë rrethanë konkrete që të krijonte dyshime të përligjura për paanshmërinë e tij. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesja ka pretenduar edhe *cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit,* pasi, edhe pse shkaqet e rekursit kishin të bënin me zbatimin e ligjit material dhe procedural dhe përbënin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një arsyetim *de plano,* pa u dhënë përgjigje konkrete pretendimeve për mungesën e një hetimi të plotë gjyqësor, barrën e provës së ATP-së dhe përcaktimin e zërit kadastral të pronës, ndërkohë që ajo gjykatë duhej të pranonte rekursin dhe ta kthente çështjen për rishqyrtim.

22. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje së të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, vëren se Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata kompetente për të shqyrtuar ankimet ndaj vlerësimit financiar të ATP-së, ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkueses për zërin kadastral "truall" dhe mënyrën e përcaktimit të vlerës financiare. Ajo ka vlerësuar se dokumentacioni ligjor i administruar në dosje nuk mundësonte përcaktimin e zërit kadastral të origjinës, se skica bashkëlidhur vendimit të KKKP-së, Kavajë nuk mundësonte planvendosjen e pronës dhe se nuk kishte hartë tjetër mbi të cilën të mund të mbështetej përcaktimi i këtij zëri. Në këto kushte, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjendej përpara rastit të parashikuar nga ligji nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore për pamundësinë objektive të përcaktimit të zërit kadastral dhe ka zbatuar mekanizmin përkatës të vlerësimit. Po kështu, ajo i ka dhënë përgjigje pretendimit për zbatimin e VKM-së nr. 1620/2008, duke vlerësuar se ky akt ishte shfuqizuar.

26. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje me rekursin e kërkueses, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Sipas atij kolegji, në respekt të standardeve të KEDNJ-së dhe atyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si dhe në mbështetje të nenit 473/a të KPC-së, nga shqyrtimi i rrethanave të konstatuara nga gjykata e faktit, në rekursin e paraqitur nuk është

argumentuar asnjë shkak i vlefshëm ligjor në kuptim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe po ashtu nuk ka ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet *ex officio* nga Gjykata e Lartë.

27. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesja kundërshton, në thelb, mjaftueshmërinë e hetimit gjyqësor dhe mënyrën e shpërndarjes së barrës së provës, duke pretenduar se gjykata e apelit duhej të kishte administruar dokumentacion shtesë nga organet publike për të përcaktuar zërin kadastral të pronës. Megjithatë, përcaktimi se cilat prova duhet të administrohen, çfarë fuqie provuese kanë ato dhe nëse dokumentacioni konkret është i mjaftueshëm për të vërtetuar një fakt i përket, në parim, juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Kontrolli kushtetues mund të ndërhyjë vetëm kur mënyra e administrimit ose vlerësimit të provave shfaq arbitraritet të dukshëm ose ka cenuar në mënyrë thelbësore garancitë procedurale të palës. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit ka identifikuar çështjen e zërit kadastral, ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar dhe ka dhënë arsyet përse e ka konsideruar atë të pamjaftueshëm për të provuar zërin "truall". Vetëm fakti se kërkuesja mban një qëndrim të ndryshëm për dokumentacionin që duhej të administrohej dhe për mënyrën sesi gjykata e apelit ka zbatuar rregullat mbi barrën e provës nuk mjafton, në mungesë të elementeve të arbitraritetit të dukshëm ose të cenimit thelbësor të garancive procedurale, për ta ngritur këtë mosmarrëveshje në nivel kushtetues.

28. Nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesja, gjykata e apelit ka dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e saj lidhur me zërin kadastral në këndvështrim të parashikimeve të zbatueshme të ligjit nr. 133/2015, duke arsyetuar vendimmarrjen e saj si për sa i përket mënyrës së përllogaritjes së vlerës financiare të pronës, ashtu edhe së drejtës për kompensim sipas vendimit nr. 50/1994 të KKKP-së, Kavajë. Nga ana tjetër, arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është në përputhje me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas jurisprudencës kushtetuese, për sa kohë që ka pasqyruar pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në rekurs dhe është shprehur mbi shkaqet e mospranimit të tij në kuadër të shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit. Fakti që Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të veçantë secilit prej argumenteve të rekursit nuk e bën arsyetimin e vendimit të saj të pamjaftueshëm në aspektin kushtetues, për sa kohë nga vendimi, i lexuar në tërësi dhe në lidhje me shkaqet e rekursit të pasqyruara në të, është e kuptueshme baza juridike e mospranimit dhe, në rrethanat konkrete, nuk rezulton se ka mbetur pa përgjigje ndonjë pretendim me natyrë kushtetuese që, për nga rëndësia dhe ndikimi në përfundimin e procesit, kërkonte një përgjigje të posaçme. Po kështu, nga

përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara nuk rezulton ndonjë interpretim ose zbatim haptazi arbitrar i ligjit material ose procedural, në atë masë sa gabimi i pretenduar të mos mbetet më në planin e ligjshmërisë, por të marrë natyrë kushtetuese dhe ta bëjë procesin, në tërësi, të padrejtë. Për më tepër, në këtë drejtim siç është theksuar më sipër (*shih paragrafët 18 dhe 23 të vendimit*) çështjet e rivlerësimit të provave e përcaktimit të fuqisë së tyre provuese dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve për zbatimin e ligjit, për sa kohë nuk shfaqin arbitraritet të dukshëm ose cenim të garancive kushtetuese, u përkasin gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

29. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkueses për cenimin e *së drejtës së aksesit* në gjykatë dhe *standardit të arsyetimit* të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

30. Së fundi, Kolegji çmon të evidentojë se, për sa i përket standardit të pragut minimal të kompensimit në rastet kur zëri kadastral i pronës ka pësuar ndryshime, Gjykata, në jurisprudencën e saj dhe në vijim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, ka evidentuar kërkesën që shpërblimi të garantohet në një masë jo më të ulët se 10% e vlerës së pronës sipas zërit kadastral aktual *(shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, kjo çështje nuk ka qenë objekt i procesit gjyqësor dhe as është ngritur si pretendim nga kërkuesja. Po kështu, nga rrethanat e çështjes konkrete nuk rezulton ndonjë element që të kërkonte shqyrtimin e saj kryesisht në kuadër të këtij ankimi kushtetues.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.